



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

**01.Nr. 16-30558/15**  
**Kaçanik, 29. 09. 2015**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës(Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nentor 2010),si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

## **VENDIM**

### **Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të qarrit ( Quercus cerris ) në Kaçanik të Vjetër si monument i natyrës**

**1.** Me këtë Vendim merren nën mbrojtje vlerat e natyrës Trungu i Qarrit ( Quercus cerris) në fshatin Kaçanik i Vjetër - Komuna e Kaçanikut si monumente të natyrës të karakterit botanik (në tekstin e mëtejme - Monumenti i Natyrës).

**1.1.** Monumenti i natyrës ndodhet në varrezat e fshatit në lagjen e Krasniqve në lartësinë mbidetare 539 m, parcela kadastrale numër 00422-0 , koordinatat:**LAT:** 42.295080, **LONG:** 21.227703.

**1.2.** Perimetri i trungut është 5.10 m, lartësia 24 m, diametri i kurorës 16 m.

**1.3.** Moshja e trungut sillet moshës sillet rreth 350 vjet.

**1.4.** Trungu është i dëmtuar nga faktori antropogjen dhe kurora e tij është e krasitura në pjesën e poshtme.

**2.** Monumenti i natyrës spas IUCN-it, kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës

**2.1.** Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në monumentin e natyrës ndalohet:

**2.1.1.** Prerja e trungjeve, thyerja (krasitja) e degëve, mbledhja e gjetheve,

**2.1.2.** Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

**2.1.3.** Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbrimit të sipërfaqës mbrojtur ,

**2.1.4.** Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur ,

**2.1.5.** Ndryshimi i pamjes së sipërfaqe së mbrojtur ,

**2.1.6.** Hapja e varrezave në sipërfaqen e mbrojtur dhe

**2.1.7.** Çdo lloj aktiviteti tjetër që mundë të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e monumentit të natyrës.

**2.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:**

**2.2.1.** Të gjitha masat e mbrojtëse biologjike-teknike të monumentit të natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit të natyrës.

**3. Në zonën buferike të monumentit të natyrës ndalohe:**

**3.1.** Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera ,

**3.2.** Ndërrimi kulturës ,

**3.3.** Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

**4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut.**

**4.1. Komuna është e detyruar :**

**4.1.1.** Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara mbrojtëse,

**4.1.2.** Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre, menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

**4.1.3.** Të bëjë shenimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shenjimin e Zonave të Mbrojtura.

**5.** Planet hapësinore dhe urbanistike , projektet, baza ekonomike-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

**6.** Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**7.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,

2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,

3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,

4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe

5. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Xhelal Gashi

